FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

UJE PER INJEKSION

Tretës për përdorim parenteral
(Ujë për injeksion)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se vëreni ndonjë efekt anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Uje per injeksion dhe përse përdoret?
2. Përpara se të përdorni Uje per injeksion
3. Si ta përdorni Uje per injeksion?
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Uje per injeksion?
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË UJE PER INJEKSION DHE PËRSE PËRDORET?

Uji për injeksion është një lëndë e pastër kimike, sterile dhe jopirogjene.
Uji për injeksion përdoret si tretës për përgatitjen e tretësirave për injeksion, duke tretur barnat në trajtë të ngurtë (pluhur i liofilizuar ose tabletë), të ambalazhuara në ampula ose shishe të vogla (flakone), ku sigurohet steriliteti i tyre.

2. PËRPARA SE TË PËRDORNI UJE PER INJEKSION

Tregoni kujdes të veçantë me Uje per injeksion
Pyesni mjekun tuaj përpara se të përdorni Uje per injeksion.

KUJDES: Uji për injeksion është hipotonik dhe hemolitik dhe nuk duhet injektuar pa realizuar më parë izotonizimin e tij me tretësirat përkatëse.

Marrja e barnave të tjera
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të përdorni këtë bar.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk pritet që ky preparat të ketë ndikim mbi aftësinë për të drejtuar automjetin dhe përdorur makineri.

3. SI TA PËRDORNI UJE PER INJEKSION?

Sasia e ujit për injeksion që nevojitet për tretjen e barnave të ndryshme varet nga lloji i barit, dozimi dhe mënyra e përdorimit.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Nuk janë konstatuar efekte të padëshirueshme.

5. SI TA RUANI UJE PER INJEKSION?

Ruajeni në një vend të thatë dhe të freskët, në një temperaturë jo më shumë se 25°C.
Mos e ruani në ngrirje.
Ruajeni barin në një vend të sigurt ku fëmijët nuk mund ta marrin. Bari mund t'i dëmtojë ata.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Uje per injeksion
Çdo ampulë përmban përkatësisht 2 ml, 5 ml ose 10 ml ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit
Kuti kartoni me 10 ampula (2 ml, 5 ml ose 10 ml)

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Janar 2024.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.